Nr._____Prot Shkodër, më ___.___.2026

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës tuaj, administruar pranë Bashkisë Shkodër Nr. Prot. 18690 datë 17.07.2025, bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", pas shqyrtimit të kërkesës tuaj e cila ishte në përputhje me kërkesat e ligjit të specifikuar, ju informojmë si më poshte:

Projekti i Kartës së Studentit të Bashkisë Shkodër përfaqëson një iniciativë të rëndësishme në mbështetje të studentëve dhe të rinjve, me synim lehtësimin e aksesit të tyre në një gamë të gjerë shërbimesh, aktivitetesh dhe mundësish përfitimi. Përmes këtij projekti, Bashkia Shkodër synon të krijojë një mekanizëm konkret mbështetës për studentët, duke mundësuar përfitime dhe oferta të dedikuara në fusha të ndryshme të jetës së përditshme, edukimit, kulturës, sportit, shërbimeve dhe argëtimit.

Puna për hartimin dhe zhvillimin e projektit të Kartës së Studentit, si dhe për krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me subjektet partnere, ka nisur në shtator të vitit 2024. Gjatë viteve 2024 dhe 2025, është zhvilluar një proces i vazhdueshëm pune për konsolidimin e konceptit të kartës, identifikimin e kategorive të shërbimeve, krijimin e partneriteteve dhe finalizimin e mekanizmave të nevojshëm për funksionimin e saj.

Karta e Studentit u lancua zyrtarisht në maj të vitit 2026, në kuadër të një eventi të posaçëm, gjatë të cilit u bë edhe shpërndarja e kartave fizike për studentët. Lançimi shënoi përfundimin e një procesi të gjatë pune dhe vënien në funksion të një instrumenti konkret për mbështetjen e studentëve.

Pas lançimit zyrtar të projektit, deri aktualisht janë administruar gjithsej 783 aplikime, nga të cilat:

- 706 karta aktive;
- 0 karta inaktive;
- 77 aplikime të reja, të cilat janë në proces administrimi.

Në këtë mënyrë, aktualisht 706 studentë janë pajisur me karta aktive, ndërsa procesi i administrimit të aplikimeve të reja vijon në mënyrë të vazhdueshme.

Një element i rëndësishëm i projektit është krijimi i një rrjeti të gjerë partneritetesh me subjekte private dhe ofrues të ndryshëm shërbimesh. Aktualisht, në kuadër të Kartës së Studentit janë të përfshira 40 biznese private partnere, të cilat ofrojnë përfitime, zbritje dhe oferta të dedikuara për studentët, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Shërbimet dhe përfitimet e ofruara përmes Kartës së Studentit mbulojnë një gamë të gjerë kategorish, duke përfshirë: transport, shërbime bankare, argëtim, HORECA (hotele, restorante dhe kafene), shopping, klinika dentare, laboratorë mjekësorë, dyqane teknologjike, librari, optika, fitness, farmaci, kompani sigurimesh, autoshkollë, klube sportive, telekomunikacion, kinema, galeri arti, biblioteka, muz, teatro, parqe dhe hapësira rekreative, kurse dhe trajnime, hostele dhe struktura akomoduese, si dhe qendra shërbimesh.

Përveç partneriteteve me subjektet private, në kuadër të Kartës së Studentit janë të përfshira edhe 86 shërbime publike, nga të cilat 10 janë institucione në nivel lokal, ndërsa 76 janë shërbime të ofruara në nivel kombëtar. Përfshirja e këtyre shërbimeve zgjeron ndjeshëm mundësitë e përfitimit për studentët dhe e shndërron Kartën e Studentit në një instrument më gjithëpërfshirës, me akses në një numër të konsiderueshëm shërbimesh dhe mundësish.

Realizimi i projektit është bërë i mundur përmes një modeli bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Shkodër, donatorëve, partnerëve privatë dhe burimeve të brendshme institucionale. Për projektin nuk është akorduar një fond i dedikuar drejtpërdrejt në buxhetin e Bashkisë, duke e bërë fondin e dedikuar buxhetor 0 lekë. Një kontribut i rëndësishëm është dhënë nga Union Bank, e cila ka mbështetur zhvillimin e sistemit me një donacion prej rreth 6,000 eurosh.

Pjesa tjetër e projektit është realizuar përmes angazhimit dhe ekspertizës së stafit të brendshëm të Bashkisë Shkodër, veçanërisht të stafit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe përmes kontributit teknik dhe administrativ të strukturave përkatëse. Prodhimi i kartave fizike është realizuar nëpërmjet rialokimeve buxhetore.

Në tërësi, Karta e Studentit e Bashkisë Shkodër përfaqëson një model bashkëpunimi institucional dhe ndërsektorial, i cili synon të krijojë përfitime konkrete dhe të prekshme për studentët. Përmes zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit të partnerëve dhe kategorive të shërbimeve, projekti synon të vijojë të zhvillohet dhe të ofrojë gjithnjë e më shumë mundësi për studentët, duke kontribuar në përmirësimin e aksesit të tyre në shërbime, aktivitete dhe oferta të dedikuara.

Me respekt,

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI